



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2018:053134

Datë: 24.10.2019

Numri i dokumentit: 00599093

**P.nr.749/18**

### NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti i Përgjithshëm,** gjyqtari i vetëm gjykues Mentor Bajraktari, me procesmbajtësen Bute Ramosaj – sekretare juridike pranë kësaj gjykate, në lëndën penale kundër të akuzuarit Gj.A., Komuna e Gjakovës, për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nënpar.1.4 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë–Departamenti i Përgjithshëm, me numër PP.nr.1362/18, të datës 19.10.2018, në seancën publike të shqyrtimit fillestar, të mbajtur **me datën 18.10.2019**, në prezencën e Prokurores së shtetit Mone Sylja, të dëmtuarës N.A., të akuzuarit si dhe mbrojtësit të tij av.A.R. nga Gjakova, në të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datën 24.10.2019 e përpiloi këtë:

### A K T G J Y K I M

#### I akuzuari:

**GJ.A.**, nga i ati S., e ëma Z., e gjinisë M., data e lindjes..., Komuna e Gjakovës, i martuar, babai i një fëmije, ka të kryer 6 vite të shkollës fillore, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike- përfitues i ndihmës sociale, shqiptar-shtetas i Republikës së Kosovës, numër personal...

### Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse me datën 12.09.2018, rreth orës 20:30 minuta, në shtëpinë e tyre të përbashkët, Komuna e Gjakovës, i shkakton lëndime të lehta trupore personit tjetër, në atë mënyrë që pas një konflikti verbal një ditë më parë, në mes të dëmtuarës dhe bashkëshortes së të akuzuarit, i akuzuari i revoltuar me të dëgjuar se e dëmtuara kishte ofenduar bashkëshorten e tij me fjalën “Kurvë”, e godet pa asnjë arsye me shuplaka dhe grushte në kokë dhe pjesë tjera të trupit, me ç’rast të dëmtuarës N. i shkakton lëndime të lehta trupore.

Me këto veprime ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nënpar.1.4 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në kuptim të neneve 4, 7, 17 par.1, 41, 42, 49, 50, 51, 52, 73, 74 dhe nenit 188 par.1 nënpar.1.4 të KPRK-së, të akuzuarit i shqipton:

## D Ë N I M I N M E K U S H T

Duke ia vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 4 (katër) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda afatit të verifikimit prej 1 (një) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen veprë tjetër penale.

**URDHËROHET** Shërbimi Sprovues i Kosovës në Gjakovë që ta mbikëqyrë dhe ta ekzekutojë Dënimin me Kusht, ashtu që **OBLIGOHET** i akuzuari Gj.A. të mbajë kontaktin me Shërbimin Sprovues të Kosovës në Gjakovë.

I akuzuari Gj.A., lirohet nga shpenzimet e procedurës penale dhe të njëjtat bien në llogari të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

### A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm, pranë kësaj gjykate ka ngritur aktakuzën PP.nr1362/18, të datës 19.10.2018, kundër të akuzuarit Gj.A., Komuna e Gjakovës, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nënpar.1.4 të KPRK-së. Gjatë shqyrtimit fillestar Prokuroria e shtetit Mone Syla, ka qëndruar në tërësi pranë aktakuzës kundër të akuzuarit, andaj i ka propozuar gjykatës që i njëjti të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

I akuzuari Gj.A., gjatë shqyrtimit fillestar ka deklaruar se: e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet dhe shtuar se jam penduar tepër për këtë veprim, i kërkoj falje motrës time N. dhe i premtoi gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsërisë veprime të tilla, ngase tani me motrën time N. vazhdojmë të jetojmë së bashku me një shtëpi.

Prokuroria e shteti Mone Syla, duke dhënë mendim rreth pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit ka deklaruar se: nuk e kundërshtoj pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, pasi që i njëjti pranimin e fajësisë e bën me vetëdije dhe vullnet të plotë pa presion, i njëjti ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, po ashtu pranimi i fajësisë mbështetet edhe në provat dhe në faktet që janë bashkëngjitur aktakuzës.

E dëmtuara N.A., duke dhënë mendim rreth pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit ka deklaruar se: nuk e kundërshtoj pranimin e fajësisë, si e dëmtuar deklaroj se nuk i bashkëngjitem ndjekjes penale, meqenëse me vëllain tim Gj. jetojmë në një shtëpi dhe prej asaj kohe nuk kemi pasur ndonjë problem tjetër, jemi pajtuar, ja kam falur rastin prandaj edhe nuk parashtrojë kërkesë pasurore-juridike nuk kërkoj kompensim demi për lëndimet e shkaktuara.

Mbrojtësi i të akuzuarit Gj.A., av.A.R., duke dhënë mendim rreth pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit ka deklaruar se: pas konsultimeve të mjaftueshme me të akuzuarin Gj., i njëjti ka pranuar fajësinë, për veprën e kryer, është penduar pa mase duke u zotuar se në të ardhmë nuk do të ndodhin raste të njëjta apo të ngjashëm do të kujdeset për motrën aq sa ka mundësi fizike dhe materiale andaj, i propozoi Gjykatës që gjatë shqiptimit të dënimit, të ketë parasysh favoret që ligji i parasheh të pranimit i fajësisë, nga ajo kohë gjegjësisht nga data 12.09.2018 e deri me sot nuk ka ndodhur asnjë mospajtim në mes këtu palës se dëmtuar dhe të akuzuarit rrethana të cilën e pranoi edhe vetë pala e dëmtuar, por gjithnjë duke u zotuar i akuzuari që në të ardhmë nuk do të ndodh një gjë e tillë, andaj i propozoi Gjykatës që të bije një masë të lehtë të dënimit .

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Në tërësi është vërtetuar se i akuzuari Gj.A., me datën 12.09.2018, rreth orës 20:30 minuta, në shtëpinë e tyre të përbashkët, Komuna e Gjakovës, i shkakton lëndime të lehta trupore personit tjetër, në atë mënyrë që pas një konflikti verbal një ditë më parë, në mes të dëmtuarës dhe bashkëshortes së të akuzuarit, i akuzuari i revoltuar me të dëgjuar se e dëmtuara kishte ofenduar bashkëshorten e tij me fjalën “Kurvë”, e godet pa asnjë arsye me shuplaka dhe grushte në kokë dhe pjesë tjera të trupit, me ç’rast të dëmtuarës N. i shkakton lëndime të lehta trupore.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari, i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-së. Gjatë pranimi të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij av.A.R., pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokuroria e shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike dhe se nuk ekziston asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 253 paragrafët 1 dhe 2 të KPP-së, për pushimin e procedurës penale përkatësisht hedhjen e aktakuzës.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nënpar.1.4 të KPRK-së dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin të shpall fajtor dhe ta gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara si në nenin 73 dhe 74 të KPRK-së të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit: është baba i një fëmije, është i gjendjes së dobët ekonomike- përfitues i ndihmës sociale, mbajtës i familjes prej 9 anëtarësh, të ardhurat i siguron vetëm përmes ndihmës sociale, në gjykim ka pasur qëndrim tejet korrekt, pranimin e fajësisë në shqyrtimin fillestar, pendimin e tij duke i kërkuar falje publikisht motrës së tij, premtimin se në të ardhmen nuk do të përsërisë veprime të këtilla, do të jetë më i kujdesshëm, faktin që më parë nuk ka qenë i dënuar. Kështu që duke mos gjetur rrethana rënduese për të akuzuarin gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuar si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 41 dhe 50 i KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikoj në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Gjykata të dëmtuarën N. (S.) A., Komuna e Gjakovës, nuk e ka udhëzuar në kontest të rregullt juridiko-civil për realizimin e kërkesës pasurore-juridike pasi që e njëjta gjatë shqyrtimit fillestar ka deklaruar se nuk parashtrojë kërkesë pasurore-juridike nuk kërkoi kompensim demi nga i akuzuari për lëndimet e shkaktuara.

Vendimi mbi lirimin nga shpenzimet e procedurës penale për të akuzuarin është marr konform nenit 453 par.4 të KPP-së, për faktin se gjykata konsideron se me pagimin e shpenzimeve do të rrezikohet gjendja materiale e të akuzuarit pasi që është e gjendjes shumë të dobët ekonomike, është përfitues i ndihmës sociale, ku i akuzuari gjatë shqyrtimit fillestar, gjykatës ia ka dorëzuar një kopje të kartelës për ndihmë sociale përmes të cilës vërtetohet se është përfitues i ndihmës sociale pranë Qendrës për Punë Sociale në Gjakovë.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 365 të KPP-së.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË**  
**- Departamenti i përgjithshëm -**  
**P.nr.749/18, me datë 18.10.2019**

**Procesmbajtësja,**  
**Bute Ramosaj**

**Gjyqtari i vetëm gjykues,**  
**Mentor Bajraktari**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese, në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.